

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndërtim shpatulla e këmbza ure (për urë bejli), mbi përroin e prodanit (lidhja e fshatrave Prodan-Gjonç), Bashkia Kolonjë, viti 2026”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Punime gjërmimi 45112000-5; Punime ndërtimi 45210000-2; Punime betoni 45262300-4

VLERA E FONDIT LIMIT: 6,000,000.0 (gjashtëmilion) lekë pa T.V.SH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”; Nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kolonjë** ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi:Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 77, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas percaktimeve te bera ne Shtojcen 7 te DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin39, pika 6/b, të VKM nr. 285,datë 19.05.2021, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,i ndryshuar.

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimitaponevojëneqëoperatorët ekonomikë të regjistrohesh në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024 dhe 2025**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, e LPP, nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar; si dhe ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Në nenin 77, **pika 1 dhe 3**, e LPP parashikohet:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Ne nenin **43**, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nder te tjera parashikohet:

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Gjithashtu eshte kerkuar qe vlera minimale e xhiros vjetore per tu permbushuar nga operatorët ekonomikë, duke qene se lloji i procedures eshte e hapur e thjeshtuar, te jete jo me e ulet se 40 % e fondit limit.Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”,si dhe Ligjin 9920 datë 19.05.2008 , për Procedurën Tatimore, neni 64 Deklarata Tatimore. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

Autoriteti Kontraktor në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji,pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të**

vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore në vendin ku operatori ka zyrën qendore të shoqërisë **për vitin 2025** (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore **dhe për vitin e fundit 2026 (këstet e maturuara).**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 39, nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm **në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet** dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, **është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet .**

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a)** Për kontrata të realizuara me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas **shtojcës Nr. 9**, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje,
 - Situacionin përfundimtar të objektit dhe faturën tatimore,
 - Aktin e kolaudimit të objektit ,
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim, **ose** Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim.
- b)** Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar të objektit dhe faturën tatimore,
 - Aktin e kolaudimit të objektit ,
 - Çertifikatën e marrjes në dorëzim, **ose** Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar **në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pika 4**, ku parashikohet se:

“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme

njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën

dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se:

Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurën e hapur duhet të jetë: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht **në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet**, për një objekt të vetëm, ose **jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet**, për punët totale të ngjashme të kryera në **5 vitet e fundit**, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulët monetar, punët e mëparshme të ngjashme janë minimalisht **në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet**, për një objekt të vetëm, ose **jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet**, për punët totale të ngjashme të kryera **në 5 vitet e fundit**, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar dhe përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe në këtë mënyrë, Autoriteti Kontraktor ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së Autoritetit Kontraktor.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës.

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39, pika 8, parashikohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

Sipas këtij neni, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë.10.09.1998, *“Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit”*, (i ndryshuar), Udhezimi i K.M nr.2, datë.13.05.2005, *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*, Udhezimin Nr.3 datë 15.02.2001 *“Për Mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”* “ te ndryshuar, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës për të vërtetuar kërkesat e përcaktuara në nenin 39 , pika 5/a dhe 5/b, duhet të paraqesin **Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9, kontratat e sipërmarrjes, Situacionin përfundimtar të objektit dhe faturën tatimore , Aktin e kolaudimit të objektit, Çertifikatën e marrjes në dorëzim, ose Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim për punët e kryera me entet publike**, që Autoriteti Kontraktor të bindet që operatori ekonomik me anë të dokumentacionit të paraqitur plotëson

kriterin për punë të ngjashme ku shihen zërat e punimeve që ka realizuar, koha e realizimit, dokumentacioni i kolaudimit dhe marrjes në dorëzim të objektit si dhe vlerësimi i dhënë nga Autoriteti Kontraktor, elemente të nevojshëm për të gjykuar për plotësimin e kriterëve për punë të ngjashme.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatorët ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga institucioni përkatës MPPT/MTI/MIE e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

1. NP– 1 A Punime gjurmimi në tokë
2. NP– 4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
3. NP– 5 A Punime nentokesore, ura e vepra arti.

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

1. NS– 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve
2. NS– 8 A Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
3. NS– 18 A Punime topogjeodezike.

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar.

Përcaktimi i kategorisë së licencave bazohet në kriteret të përcaktuara ligjore e teknike. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane."

Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomik të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko profesionale ne nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Licencat janë të lidhura ngushtësisht me zërat e punimeve të ndërtimit. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti i vlerëson të nevojshme, për sa kohë ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar.	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës.	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse.	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respective.	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse.
PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI				
NP– 1	Punime gjurmimi në tokë	Sipas zërave të preventivit	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar.
NP– 4	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.	Sipas zërave të preventivit	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar.
NP– 5	Punime nentokesore, ura e vepra arti.	Sipas zërave të preventivit	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar.
PUNIME SPECIALE NDERTIMI				
N.S-1	Punime për prishjen e ndërtimeve.	Sipas zërave të preventivit	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar.
N.S-8	Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.	Sipas zërave të preventivit	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar.
N.S-18	Punime topogjeodezike.	Sipas zërave të preventivit	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar.

2.3.3 Stafi kryesor e mbështetes, punonjesit, çertifikimet

- a. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si mëposhtë:

1) Inxhinier Ndërtimi

1 (një)

Për të cilin duhet të paraqiten:

- Kontratë punë e noterizuar
- Diploma
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**
- Operatori/et ekonomike ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga administratori i shoqërisë) **Drejtuesin/t Teknik** të punimeve në objekt i cili duhet të jetë **(Inxhinier Ndërtimi)**,

- Gjithashtu së bashku me deklaratën e operatorit ekonomik kërkohet edhe dhënia e deklaratës personale nga vetë drejtuesi teknik i operatorit ekonomik ku i bashkëngjitet deklaratës së subjektit ofertues. **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës.**

Në rast deklarimi të rremë do të veprohet në përputhje me nenin 78, pika 1, gërma "a" të Ligjit Nr.162/2020 datë.23.12.2021 "Për Prokurimin Publik".

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", "Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie" në nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, bazuar në Rekomandimin Nr. 6732 date 21.10.2020" "Mbi Problematikat e konstatuara gjatë monitorimit nga APP" , ligjin 8402 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" datë.10.09.1998 i ndryshuar, pasi për çdo objekt zbatimi duhet të ketë drejtuesin e saj teknik i cili ushtron detyrat e tij në përputhje me këtë ligj .

Është kërkuar **inxhinier ndërtimi** për zbatimin e punimeve në përputhje me zërat e punimeve të preventivit ,projektit, specifikimeve teknike dhe të grafikut të punimeve që do të zbatohen si dhe kategorive përkatëse në licencën përkatëse të zbatimit.

Inxhinieri i Ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve për pjesën e sheshit, zbërthimin e projektit të zbatimit, punimet e përgjithshme të ndërtimit etj. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve .

- b. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar / të kualifikuar, si mëposhtë:**

NR	EMERTIMI	
1	Teknik i mesëm ndërtimi	(1 person)
2	Hekurthyes	(1 persona)
3	Karpentier	(1 persona)
4	Punues Guri	(2 persona)
5	Specialistë ndërtimi (Murator)	(1 persona)
6	Punëtorë ndërtimi	(2 persona)
7	Manovratorë mjetesh të rënda Automakinist	(2 persona)
8	Shofer	(2 persona)
		12 punonjës

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës dhe dëshmi (diplomë ose çertifikatë),që të vërtetojë kualifikimin profesional lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licensuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore sipas ligjit nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë".
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërise **minimalisht për muajin e fundit.**
- Shofer dhe Manovratorë mjetesh të rënda duhet të jenë punonjës të specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin dëshminë e aftësisë profesionale nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor.

- Për teknikun e mesëm duhet të paraqitet diploma ose dëftesa e përfundimit të shkollës së mesme profesionale si dhe të jenë të pajisur me dëshmi të Sigurimit Teknik e lëshuar nga ISHTI ose nga një trup çertifikuese e akredituar në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr.8734, datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.

***Në rastin kur makineritë dhe pajisjet disponohen me qera, Shofer (2 persona) dhe Automakinist (2 persona), mund të disponohen nga operatori/et ekonomik edhe nëpërmjet kontraktimit, për të cilët nuk është e nevojshme të jenë në listëpagesat e shoqërisë.**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Për punonjësit e sipër cituar operatorët ekonomikë duhet të paraqesin tabelën sipas të dhënave të mëposhtme:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Nr i amzës/regjstrit dhe data e lëshimit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
3					
4					
5					

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi:Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 39, pika 6, gërma c dhe ç ,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Vendosja e këtyre kriterëve për fuqinë punetore është bërë në përputhje me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është përlllogaritur si dhe mjeteve të kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

Kërkesa sa më sipër për Teknik i mesëm ndërtimi 1 (një) – është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve, si një ”urë lidhëse” ndërmjet inxhinierit të ndërtimit dhe punonjësve, në mënyrë që këtyre të fundit, tu shpjegohet në mënyrë sa më të kuptueshme projekti dhe detajet teknike të tij.

Kërkesa sa më sipër për Hekurthyes 1 (një) – janë të nevojshem për realizimin e punimeve të ndërtimit, referuar zërave konkretë të punimeve të parashikuar në preventivin e zbatimit konkretisht:për përzgjedhjen, prerjen, kthimin dhe vendosjen e hekurit.

Kërkesa sa më sipër për Karpentier 1 (një) – janë të nevojshem për realizimin e punimeve të ndërtimit, referuar zërave konkretë të punimeve të parashikuar në preventivin e zbatimit konkretisht:për prerjen dhe montimin e strukturave të armaturës për hedhjen e shtresës së betonit si dhe ndërtimin e kornizave dhe strukturave të tjera përforcuese prej druri apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e objektit që do të ndërtohet.

Kërkesa sa më sipër për Punues guri 2 (dy) – janë të nevojshem për realizimin e punimeve të ndërtimit,referuar zërave konkretë të punimeve të parashikuar në preventivin e zbatimit.

Kërkesa sa më sipër për Specialistë ndërtimi (Murator) 2 (dy) – janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të ndërtimit, referuar zërave konkretë të punimeve të parashikuar në preventivin e zbatimit.

Kërkesa sa më sipër për Punëtorë ndërtimi 2 (dy) – janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të ndërtimit, referuar zërave konkretë të punimeve të parashikuar në preventivin e zbatimit.

Kërkesa sa më sipër për Shofer 2 (dy) dhe Manovratorë mjeteve të rënda (2 Automakinist) është i nevojshëm për realizimin e punimeve të ndërtimit.

Autoriteti Kontraktor e vlerëson të nevojshme që operatori ekonomik duhet të disponojë punonjësit e kualifikuar si më sipër, pasi kjo kërkesë lidhet ngushtësisht me mjetet e kërkuara në pikën 2.3.5, të dokumentave të tenderit, në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi, ku për drejtimin e mjeteve të vlerësuar të domosdoshme për realizimin e punimeve në fjalë, nevojiten drejtuesit respektive, të pajisur me dokumentacionin përkatës, në përputhje me Kodin Rrugor dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

2.3.4 Operatori/et ekonomike ofertues duhet të disponojnë minimalist në listëpagesat e muajit të fundit punonjës të specializuar / të kualifikuar, si mëposhtë:

- a. **Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë/në në stafin e tij 1 (një) punonjës** që të disponojë dëshmi trajnimi si *“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”* në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 327 datë 18.02.2010 *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”* dhe VKM Nr. 312 date 05.05.2010 *“Për miratimin e rregullores”*, *“Për sigurinë në kantier”*. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqiten: certifikata e trajnimit për *“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”*, e dhënë nga një organizëm i licencuar, shqiptar ose i huaj .

Për të cilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës
- Të figurojë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, **në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, **i ndryshuar** , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* dhe 39, pika 6, gërma c dhe ç ,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021*“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, **për 1 (një) punonjës** që të disponojë dëshmi trajnimi si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”** në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 327 datë 18.02.2010 *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”* dhe VKM Nr. 312 date 05.05.2010 *“Për miratimin e rregullores”*, *“Për sigurinë në kantier”*. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqiten: certifikata e trajnimit për *“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit për punë”*, është në proporcion me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit,mbi sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimevetë nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, **i ndryshuar** , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi:Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë

të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri dhe përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës.

Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilet janë të certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" dhe "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave", janë të nevojshëm për të menaxhuar emergjencat gjatë punimeve dhe të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit në punë.

b. Operatori/et ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 14 (Katërmëdhjetë) persona për muajin e fundit, të vërtetuar me:**

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, **për muajin e fundit.**
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi **për muajin e fundit.**

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe 39, pika 6, gërma ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, nga zbërthimi i preventivit të punimeve me manualin e miratuar me Vendimin Nr.216 datë.13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve të ndërtimit".

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur referuar zbërthimit të zërave të preventivit duke u bazuar tek grafiku i punimeve të hartuar nga projektuesi, ku është parashikuar kryerja e këtyre proceseve brënda afateve kohore të caktuara në grafik.

Nevojiten:

Teknik i mesëm ndërtimi	(1 person)
Hekurthyes	(1 person)
Karpentier	(1 person)
Punues Guri	(2 persona)
Specialistë ndërtimi (Murator)	(1 person)
Punëtorë ndërtimi	(2 persona)
Manovratorë mjetesh të renda Automakunist	(2 persona)
Shofer	(2 persona)

Personel kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, dhe mbështetes si mëposhtë:

Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
1 (një) punonjës që të disponojë dëshmi trajnimi si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”	1 (një)

Totali 14 persona

Në lidhje me vërtetimin të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve kjo kërkesë është e mbështetur në Nenin 39, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

c. Operatori/et ekonomike duhet të paraqes/in Certifikata ISO ose ekuivalente dhe duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit:

- ISO 9001:2015 (ose ekuivalente)
- ISO 45001-2018 (ose ekuivalente)
- ISO 14001:2015 (ose ekuivalente)

Autoriteti kontraktor do të pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN; SSH/ISO mbi komformitetin e standardit europian apo atij ISO, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

VO: Nëse certifikatat nuk janë në gjuhën shqipe të jenë të përkthyer dhe të noterizuara si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes së objektit të kontratës, që do të prokurohet dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit.

Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose

të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 10 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 7 – max 10 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Eskavator me zinxhir	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Betoniere min 150 litër	copë	2	Në pronësi ose me qera
5	Rul ngjeshës	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Vibrator për beton	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Fadromë	copë	1	Në pronësi ose me qera

Si dëshmi për plotësimin e kësaj pike Operatori/et ekonomik duhet të paraqesë:

- Për mjetet me rrota/goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (lejë qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme).*
- Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit,(të vlefshme). Për të gjitha mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i kontratës.*
- Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre,apo marrjen me qira te tij: aktet e zhdoganimit në Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore të blerjes.*
- Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerine ekytyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.*

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimevetë nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, **i ndryshuar** , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, VKM nr.629 datë.15.07.2015, manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave të tyre dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Referuar VKM Vendimin Nr.**216** datë.**13.04.2023** “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve të ndërtimit”,është bërë përllogaritja teknike e mjeteve/ makinerive/ pajisjeve të nevojshme për zbatimin e kontratës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës,nevojiten:

Emri i mjetit	Njesi	Sasi
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 10 ton		

	copë	1
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 7 – max 10 ton	copë	1
Eskavator me zinxhir	copë	1
Betoniere min 150 litër	copë	2
Rul ngjeshës	copë	1
Vibrator për beton	copë	1
Fadromë	copë	1

Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 10 ton

Mjet që përdoret për transportin e materialeve bazuar në zërin e preventivit transport dheu, transport materiale ndërtimi.

Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 7 – max 10 ton

Mjet që përdoret për transportin e materialeve të imëta sjelljen e tyre në objekt dhe transportin e materialeve të ndryshme brenda kantierit.

Eskavator me zinxhir

Mjet që përdoret për punime gërmimi dhe hapjen e materialit të shtresave

Betoniere 150 litra

Pajisje që përdoret bazuar në zërin e preventivit për punime betoni në zona ku është e pa mundur kalimi me Autobetoniere dhe Autopompë betoni.

Rul ngjeshës

Mjet që përdoret për ngjeshjen e shtresave në trup të rrugës

Vibrator për beton

Pajisje që përdoren për kryerjen e proceseve të ndryshme të punëve që kërkohen, në ngjeshjen e betonit duke i dhënë uniformitet dhe soliditet.

Fadromë

Shtytjen, grumbullimin, ngarkimin e materialeve dhe shtresave të dala nga prishja. Përpunimi i materialeve tek punimet e shtresave sipas preventivit: Mbushje me cakell e gur gurorë në trupin e rruges, përhapur e ngjeshur me makineri, Mbushje me zhavorr pas mureve.

2.3.6 Operatori/et ekonomik ofertues duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit të hedhur në tender të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit **për 2 (dy) muaj**.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Periudha e garancisë për defektet është **1 vit pas marrjes në dorëzim të objektit** (hartimit të proces-verbalit të marrjes në dorëzim dhe çertifikatës).

Argumentimi: Është vendosur ky njoftim duke u bazuar në ligjin 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë.10.09.1998 i ndryshuar pasi periudha e garancisë së punimeve referuar këtij ligji shkon nga 1 deri 2 vite.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike për procedurën respektive janë përgatitur nga Komisioni i përgatitjes së dokumentacionit teknik i projektit të zbatimit duke qënë elemente përbërës të tij. Në hartimin e tyre janë marrë në konsiderat kërkesat ligjore të fushës së planifikimit dhe zhvillimit të territorit si dhe normat përkatëse të Ligjit nr. 9290 , datë.7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe kërkesat e ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011 , "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore".

Specifikimet Teknike janë pjesë e setit të dokumentave të ngarkuara në SPE për procedurën respektive.

Fondi Limit i përlllogaritur për këtë procedurë është hartuar në bazë të preventivit të hartuar nga hartuesi i projektit sipas VKM Nr.216 datë.13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve të ndërtimit.

Shënim: Përcaktoni specififikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specififikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt, “**Ndërtim shpatulla e këmbza ure (për urë bejli), mbi përroin e prodanit (lidhja e fshatrave Prodan-Gjonç), Bashkia Kolonjë, viti 2026**”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Bashkëlidhur këtij proces-verbali:

Projekt zbatimin,

Preventivin,

Grafikun e punimeve,

Relacionin teknik,

Specifikimet teknike.